

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Cavaliero & Vox Palace club sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 25 Janar 2025 , u paraqiten personalisht ortakët themelues:

Enio JAHELEZI , datelindja 25/03/1980 , lindur ne _Tropoje , me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me numer personal ID I00325066C,banues në Tirane.

Flamur HYSEJNI,datelindja 12/01/1968,lindur ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me numer personal ID G80112170R ,banues ne Tirane

Kujtim LLUPA,datelindja 15/03/1975, lindur Guri Bardhë, Mat me zotesi te plote juridike per te vepruar, Identifikuar me numer personal ID H50315249H,banues ne Tirane

Deklarojme me vullnetin tone te plote e te sinqert dhe me iniciativen tone te lire dhe private mbështetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi,ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijojm shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertim **Cavaliero & Vox Palace Club sh.p.k**

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte **Cavaliero & Vox Palace Club sh.p.k**

Neni 2

Forma Juridike


Shoqëria **Cavaliero & Vox Palace Club sh.p.k** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i shoqerise, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulone personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Selia e Shoqerise eshte Njesia Bashkiake Nr. 4, Rruga Aleksander Moisiu ,ambient brenda Kinostudios, Perball Karburant Kastratit, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut të Shoqërisë.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem(vetem nese eshte i përcaktuar)

Bar-Pub, lokal nate me aktivitet 24 ore, Bistro, Snak-bar, Club, Longe. Mikpritje organizim eventesh atistike, spektakle kercimi, studio dance, evente televizive. Import eksport materialesh robotike per krijim atmosfere ventesh artistike, aparatura teknologjise LED, sistem ndriçimi dhe sistem elektronik i drejtimit te ndriçimit te telekomanduar,

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpejtuar te /shoqerise ose zgjatja e afatit, duhet te behet me vendim te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë

KREU II **KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 500.000 lekë (njqind mije leke). Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre .

Ortaket themelues zotërojn 100% të kapitalit në shoqëri si me poshte:

- 1- Enio JAHELEZI zoteron 1 kuote me pjesemarrje 33 % ne kapitalin e shoqerise
- 2- Flamur HYSENI zoteron 1 kuote me pjesemarrje 33 % ne kapitalin e shoqerise
- 3- Kujtim LLUPA zoteron 1 kuote me pjesemarrje 34 % ne kapitalin e shoqerise

Kapitalit i korespondojne tre 3 kuota me vlere sa me poshte:

- 1 kuote me vlere 165.000 leke (njqindgjashetdhjetepese mije), pjesemarrja 33%
- 1 kuote me vlere 165.000 leke (njqindgjashetdhjetepese mije), pjesemarrja 33%
- 1 kuote me vlere 170.000 leke (njqindshetatedhjetete mije), pjesemarrja 34%

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësive mbi kuotën si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmerinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort në kontratë, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësive mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortakët e shoqërisë janë organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë janë organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Ortakët e shoqërisë janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët e shoqërisë mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori i shoqërisë do të jetë Flamur Hysej, lindur më 12/01/1968, në Tiranë, identifikuar me nr. Personal ID G80112170R.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Nëse asambleja e përgjithshme emeron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

g) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje te plote me kete akt themelimin statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15


Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Ortaket Themelues te shoqerise si themelues te saj pasi e lexuan me vemendje akt themelimin e mesiperm dhe duke qene konform vullnetit te tyre, e firmosin pa verejtje.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE Cavaliero & Vox Palace club sh.p.k

Enio JAHELEZI



Flamur HYSENI



Kujtim LLUPA

